

REKOMANDIME

Tema: Lufta kundër Krimet Kibernetik në Shqipëri-Sfidat e reja në kuadër të Procesit të Integritit Tryeza e Kapitullit 24 e Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian

E mërkurë, 08 shkurt 2023, 10:00 – 11:30

Kapacitetet administrative dhe strukturimi i njësisë

- *Sa i përket kapaciteteve administrative shihet si e nevojshme rritja e punonjësve të policisë sa i përket fushës së luftës kundër krimet kibernetik, që do të çonte dhe në një ndarje më të qartë të detyrave dhe specializim më të detajuar të tyre.*
- *Për të luftuar krimin kibernetik dhe gamën e gjerë të sferave dhe aktiviteteve që ai mbulon, bazuar në eksperiencën sllovaqe sugjerohet që të krijohet një njësi më e vogël me 4-5 oficerë policie të cilët të specializohen në menaxhimin dhe përdorimin e big data (duke qenë që janë komplekse por që mund të vijjnë në ndihmë nëse përdoren në mënyrën e duhur) dhe të ofrojnë mbështetje të gjithë pjesës tjetër (back up support).*
- *Rekomandohen trajnime të ndryshme, të shpeshta dhe mbi të gjitha periodike për të gjithë stafin dhe personelin puna e të cilëve lidhet me sigurinë kibernetike. Duke qenë një fushë që ndryshon me hapa të shpejta, po kaq e përditësuar dhe e përgatitur duhet të jetë dhe njësisia kundër krimet kibernetik dhe të përfshihet në trajnime dhe aktivitete me synim rritjen e njohurive dhe aftësive. Këto trajnime mund të zhvillohen dhe në bashkëpunim me ekspertë kombëtarë apo ndërkombëtarë si dhe në partneritet me vendet e BE apo agjencitë e BE.*
- *Bashkëpunimi me shtetet fqinje, partnerët ndërkombëtarë dhe pjesëmarrja aktive në platformat e përbashkëta për të shkëmbyer informacione dhe të dhëna operationale që ndihmojnë gjatë hetimeve. Për Sllovakinë bashkëpunimi me fqinjët bazuar në traktatet bilaterale, si dhe platformat Europiane EMPACT, EPE-EC3 SPACE, etj.*
- *Shpesh ndodh që struktura administrative të karakterizohet nga lëvizjet e shpeshta, duke rritur kostot në kohë dhe investime për përgatitjen e stafit të ri apo dhe riorganizimin e detyrave dhe përgjegjësi. Rekomandohet që strukturat e krijuara të kenë një qëndrueshmëri, dhe pse sugjerohet që personel i ri të vijë herëpashere, është e rekomandueshme që një strukturë bërthamë të jetë për një kohë afatgjatë.*
- *Me ristrukturimin e njësisë së krimet kibernetik, vlerësohet si shumë me rëndësi krijimi i njësi apo përgatitja e stafit jo vetëm në qendër, por caktimi i specialistëve edhe në qytete të tjera. Kjo lehtëson bashkëpunimin dhe komunikimin mes policisë së shtetit dhe qytetarëve, si dhe menaxhimin efikas të rasteve jashtë qendrës.*

- *Investimi në infrastrukturë dhe mjete të posaçme dedikuar luftës kundër krimit të organizuar duhet të jetë një tjetër prioritet. Kjo lidhet drejtpërdrejt me blerjen dhe marrjen e aparaturave, mjeteve të tjera të rëndësishme për të luftuar krimin kibernetik. Duke qenë që kjo është një fushë dinamike që zhvillohet me shpejtësi, është e nevojshme për struktura të policisë që të përditësojnë dhe të investojnë në mjetet dhe infrastrukturën e tyre.*
- *Rekomandohet krijimi i një rrjeti të posaçëm infrastrukture për njësitë e krimit kibernetik, pasi mundëson jo vetëm shpejtësi në procesimin e të dhënave, dhe procedurat hetimore, por gjithashtu një siguri të shtuar për sektorin.*
- *Si një fushë relativisht e re, por që përbën një kërcënim real për sigurinë e qytetarëve dhe vetë shteteve, Bashkimi Europian dhe agjencitë Europiane kanë vazhdimisht programe dhe fonde financiare për të ndihmuar në luftën kundër krimit kibernetik dhe mundësuar zhvillimin sa më të shpejtë të sektorit. Rekomandohet të merret pjesë në këto programe dhe të aplikohet për fondet Europiane, të cilat edhe pse kanë shumë procedura, janë përfundimisht shpërblyese për shtetet, duke i kursyer edhe disa kosto.*
- *Risite teknologjike kanë sjellë gjithashtu 'lindjen e veprave penale të reja', të cilat duhen parashikuar dhe sanksionuar në ligjet e brendshme. Për këtë arsye, Sllovakia ka krijuar një komision të posaçëm që ndihmon Ministrinë në hartimin e legjislacionit, si dhe për implementimin efektiv të Direktivës (BE) 2019/713 dhe traktateve të tjera ndërkombëtare.*
- *Fenomeni i abuzimit seksual të fëmijëve në internet përbën një shqetësim të madh dhe të gjitha format e abuzimit seksual të fëmijëve në internet duhet të kriminalizohen dhe të hetohen. Për këtë ekspertë rekomandon të shtohen përpjekjet operationale për identifikimin e viktimave, të përdoren mjetet dhe metodat e reja, si dhe krijimi i një baze të dhënash kombëtare.*

Ndërgjegjësimi dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë

- *Duke qenë që mediat sociale mbeten një burim i madh rreziku, sidomos për të rinjtë apo të miturit duhet punuar në mënyrë intensive sa i përket sigurisë dhe përdorimit të sigurt të këtyre mediave sociale duke realizuar në këtë mënyrë fushata ndërgjegjësimi në bashkëpunim me OSHC dhe ekspertë.*
- *Për këtë nga ekspertë sllovak rekomandohet dhe krijimi i një platforme online ku të rinjtë por dhe target grupe të tjera të vlerësuar si më të rrezikuar të informohen, ndërgjegjësohen dhe të sqarohen mbi përdorimin e mediave sociale dhe rreziqet potenciale që rrjedhin prej tyre, si të mbrojnë të dhënat e tyre apo si të identifikojnë këto rreziqe.*
- *Rekomandohet një bashkëpunim me kompanitë dhe ekspertët që janë të përfshirë në fusha të*



sigurisë kibernetike. Shpeshherë administratës publike i mungojnë kapacitetet apo ekspertiza e nevojshme kështu që një partneritet me kompani dhe ekspertë të cilët kanë eksperiencë në këtë fushë është me vlerë për të marrë njohuritë e nevojshme apo dhe për të asistuar në raste të caktuara në kuadër të luftës kundër krimit kibernetik.

- Një sektor i rëndësishëm që duhet të përfshihet në mënyrë aktive është dhe sistemi gjyqësor e më konkretisht gjyqtarët dhe prokurorët të cilët duhet të trajnohen dhe informohen mbi rastet e krimit kibernetik, në mënyrë që të jenë më bashkëpunues dhe më të gatshëm të përfshihen aktivisht dhe në komunikim me policinë e shtetit. Në Sllovaki, për çdo rreth një gjyqtar dhe një prokuror ishin të specializuar për krimet kibernetike, duke siguruar administrimin e duhur të drejtësisë në këto çështje.

PJESËMARRËSIT

Eksperti Sllovak: Róbert Bohunický, Byroja e Policisë Kriminale, Ministria e Brendshme e Sllovakisë

Eksperte kombëtare: Suela Bonjaku, Sektori për Hetimin e Krimit kompjuterik, Departamenti i Policisë Kriminale, Policia e Shtetit

Bashkëkryesuesit: Gledis Gjipali, Executive Director of European Movement Albania; Besfort Lamallari, Deputy Minister of Interior; Suela Jahaj, Drejtore në Drejtorinë e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, Ministria e Brendshme

Institucionet shtetërore dhe organizata ndërkombëtare

Ministria e Brendshme: Gentiana Bektashi, Leonard Bokçiu, Ingrid Dano, Denisa Cici

Policia e Shtetit: Dorina Rarani, Besart Cerri, Sami Muja, Alma Permeti

SPAK/BKH: Sadleva Bodo

Zyra e Kryenegociatorit: Ana Burda

Autoriteti Kombëtar i Certifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike: Anxhela Brahimi

Organizata Ndërkombëtare e Policisë: Mareglen Tomori, Valbona Gjoka, Josiba Osmani

Zyra e Kryeministrit të Kosovës: Novitet Nezaj



OSHC dhe Universitete

IANS: Erinda Bllaca

Albania Sustainable Development Organization: Elton Kërçiku

European Movement Albania: Nirvana Deliu, Endrita Shehu, Erina Troka

Akademia e Shkencave: Alma Bela

Universiteti Europian i Tiranës: Enri Hide

Universiteti i Tiranës: Jona Karapinjalli, Fetah Salliu

Tjetër

Esmir Rringaj, Bruss Ostreni